



Datë: 04.11.2025
Numër Protokolli: 7167/2025

A.nr.1612/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me A.nr.1612/2025, të datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesi G.M, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike, “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtëafatshme ankesa A.nr.1612/2025, e datës 21.08.2025, e parashtruar nga ankuesi G.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, G.M (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*) me datë 21.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën shenjë A.nr.1612/2025, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit në kërkesën e tij të datës 02.05.2025 për zbatimin e Vendimit Nr. 01-113/01-0073606, të datës 03.10.2023 të Njësisë e Burimeve Njerëzore të organit përkatës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa kjo e fundit, më datë 08.09.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kryetari i Këshillit, me datë 22.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 6294/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1612/2025 të datës 21.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr. 1612/2025 të datës 21.08.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshillit të datës 22.09.2025; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1612/2025, të datës 08.09.2025; Akt Emërimi i datës 18.06.2025, për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të Punës për pozitën ‘‘Drejtor i Qendrës për Punë Sociale’’; Listat e pagave nga muaji janar deri në muajin gushtë të vitit 2025; Vendimi me numër protokolli Nr. 01-113/01-01-0073606, të datës 03.10.2023, i nxjerr nga Menaxheri i Burime Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut; Kërkesë e datës 02.05.2025, dërguar nga G.M, për L.M; Vendimi me numër protokolli Nr.01-113/01-0039828, të datës 08.07.2025 i nxjerr nga Menaxheri i Burime Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut; Vendimi me numër protokolli Nr. 01-120/04-0080311/24, i datës 17.12.2024.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e jashtëafatshme, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli Nr. 01-112/01-0035005/25 të datës 18.06.2025, është i punësuar në pozitën ‘‘Drejtor i Qendrës për Punë Sociale’’, me mandat katër vjeçar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ndërsa me datë 02.05.2025, i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të organit të punësimit, me kërkesën për zbatimin e Vendimit me numër protokolli Nr. 01-113/01-0073606, të datës 03.10.2023, përmes të cilit vendim ankuesit asaj kohe i ishte njohur e drejta në përvojën e punës në kohëzgjatjen prej 13 vite e 5 muaj e 3 ditë, me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar në pagë për shkak se nuk është duke iu llogaritur përvoja e punës sipas Vendimit të datës 03.10.2023.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e dërguara nga Organi i Punësimit përmes përgjigjes së datës 03.09.2025, arriti në konstatimin se Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 08.07.2025 kishte nxjerrë vendimin Nr.01-113/010039828/2025 për korrigjimin e përvojës së punës, ashtu që ankuesit i ishte njohur e drejta në përvojën e punës në kohëzgjatje prej 15 vite e 11 muaj, ndërsa nga lista e pagave arrihet në konstatimin se ankuesit që nga muaji korrik i vitit 2025, në listën e pagave figuron se paga iu është kalkuluar duke marr për bazë edhe përvojën e punës në kohëzgjatje prej 15 vitesh e 11 muaj, mirëpo ankuesi në ankesën e tij të datës 21.08.2025 të parashtruar në Këshill, nuk ka asnjë pretendim lidhur me veprimet e fundit procedurale të organit të punësimit që lidhje me përvojën e punës të konfirmuar sipas Vendimit të datës 08.07.2025, mirëpo i njëjti pretendon se organi i punësimit ka heshtur në kërkesën e tij të datës 02.05.2025 me qëllim të zbatimit të vendimit me numër protokolli Nr. 01-113/01-0073606, të datës 03.10.2023 lidhur me konfirmimin e përvojës së punës në atë kohë në kohëzgjatje prej 13 vitesh, 5 muajsh e 3 ditë..

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, ka marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: ‘‘1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë

e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 21.08.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e jashtëafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 02.05.2025 nuk kishte vendosur apo nuk kishte nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesi të parashtrojë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbajtur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka afat kohor prej katërdhjetë e pesë (45) ditësh, e që rezulton se dita e katërdhjetë e pesë (45) për njoftimin e aktit që zgjedh kërkesën apo për trajtimin e kërkesës së ankuesit të datës 02.05.2025, ka qenë data 15.06.2025, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 21.08.2025 apo pas kalimit të afatit prej dy (2) muajsh ***pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*** nga rrjedh se ankuesi ankesën e ka parashtruar jashtë afatit të përcaktuar si në nenin 127 paragrafi 4 të LPPA-së.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.08.2025 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.*”

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr 1612/2025, datë 04/11/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.M;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së